



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 622/3 Prot.

Durrës, më 20.05.2020

VENDIM
Nr 51, datë 20.05 2020

PËR

"MIRATIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BURSIVE, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020, TË CILËT PËRMBUSHIN KRITERET PËR PËRFITIMIN E BURSIVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE PËR STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT PRIORITYARE DHE STUDENTËT NË NEVOJË, QË NDJEKIN STUDIMET NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE, PRANË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës".

Në zbatim të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", nenin 49 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 903, datë 21.12.2016, të ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 26.12.2018 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat priorityare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar me Vendimin nr. 39, datë 23.01.2019 të Këshillit të Ministrave, shkresave të Fakulteteve, Bordi i Administrimit të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, në mbledhjen e datës 20.05.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e shpërndarjes së bursave, për vitin akademik 2019 - 2020, për studentë të cilët vijnë në studimet në vitin e parë dhe pas të parit në ciklin e parë të studimeve dhe vijnë nga shtresa sociale si kategori në nevojë sipas listës bashkëlidhur të hartuar nga komisioni i verifikimit të bursave, 22 studentë.
2. Ngarkohet Administratori, Drejtorja e Administrimit financiar për verifikimin rast pas rasti të momentit kur studentit i lind e drejta për përfitimin e bursës, për të përcaktuar fillimin e efektit financiar.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - o Administratori
 - o Drejtorja e Administrimit Financiar

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar i Bordit të Administrimit
Ilirjana NANO



TABELA PERMBLEDHESHE NUMRIN E STUDENTEVE TE CIKLIT TE PARE TE CILET PERFITOINE BURSE 2019-2020

Kriteri perfities

Shkresa referuese	Fakulteti	Numri i studenteve te cilët perfitojne burse per vitin 2019-2020	Studente qe vjine nga familje qe trajtohen me ndihme ekonomike	Studente qe jane vete me aftesi te kufizuara	Studente qe kane statusin "jetim"	Studente te shkelqyer viti I dhe I trete	Studente te shkelqyer viti pare sipas QSHA -se nr 5534 date 20.11.2019	Studentët, të cilët i kane të dy prinderit me aftesi të kufizuara, të vertetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Çakmit të Aftësisë për Punë,	Studentët, të cilët i kanë të dy prinderit pensionist ose njërin prind pensionist dhe jetri nuk jeton	cilët janë të rradhën e familjeve në familje a në tre shumë, nga të cilët dy të parët janë student në institucionet	Bashkeshortët, kane humbur familjes nga temeti I	Studente te cilet kane humbur familjes nga temeti I
Shkresa nr. 133 dt.28.02.2020 e Dekanit te FB	FB	2	1	1								
Memo dt.05.05.2020 e FB	FB	1							1			
Shkresa nr. 160 dt.21.04.2020 e Dekanit te FSP	FSP	9	6	3								
Shkresa nr. 170 dt.05.05.2020 e Dekanit te FSP	FSP	2	1	1								
Shkresa nr. 138 dt.13.05.2020 e Dekanit te FTI	FTI	8	7								1	
TOTALI		22	15	5	-	-	-	-	1	1	-	-

